

Adem ZEJNULLAHU

Figura e Adem Jasharit në këngët popullore

Zhvillimi ynë historik kombëtar gjatë shekujve është përcjellë me ngjarje të shumta e të përgjakshme. Ka mes tyre humbje e ngadhënjime, tragjikë e madhështi, mbijetesë deri në ditët e sotme. E kaluara flet me gjuhën e ndjekjeve, burgosjeve, torturave, djegieve, gjyqeve të montuara, të likuidimeve dhe të etnocidit. Mirëpo, e gjithë kjo flet edhe për qëndresën, sakrificën, luftën, krenarinë, duke e poetizuar vizionin për ardhmëninë.

Kaptinë të veçantë në zhvillimet e historisë sonë paraqet lufta e armatosur e Adem Jasharit, familjes së tij dhe UÇK-së kundër okupatorit serb që shënojë faqet më të ndritshme të historisë së kombit tonë. Ngjarja e Prekazit e vitit 1998 jehoi fuqishëm në mbarë hapësirën shqiptare dhe më gjerë. Ajo u zhvillua ndërmjet familjes Jashari dhe luftëtarëve të lirisë kundër forcave të armatosura serbe. Në këtë luftë të përgjakshme në altarin e lirisë ranë njëzet anëtarë të familjes Jashari, të moshave e të gjinive të ndryshme. Kjo ngjarje me protagonistin e saj, komandantin e UÇK-së, Adem Jasharin, nxiti, frymëzoi dhe mobilizoi rininë, luftëtarët dhe popullin shqiptar për çlirim të përgjithshëm. Gjithashtu, Prekazi e tronditi thellë edhe regjimin e egër serb, si dhe e zgjoi nga hutimi faktorin e jashtëm ndërkombëtar, duke e ndërgjegjësuar për pozitën e rëndë të shqiptarëve nën sundimin e egër serbomadh, veçmas shtetet e mëdha të Evropës, të cilat disa herë në të kaluarën e dëmtuan rëndë çështjen shqiptare.

Jeta dhe historia dëshmojnë fuqishëm se ngjarjet e mëdha krijojnë epope të mëdha. Kështu, ndodhi edhe me luftën e Prekazit në krye me Adem Jasharin, lidhur me të u krijua një cikël këngësh të ndryshme të cilat e këndojnë dhe përjetësojnë këtë luftë, protagonistët e saj, të cilët luftuan dhe sakrifikuan jetën për çlirimin dhe pavarësimin e atdheut.

Emri i Adem Jasharit, lufta e tij, dhe UÇK-së u përhap si rrufeja në mbarë hapësirat shqiptare. Heroizmi i familjes Jashari u bë nxitje, simbol, frymëzim për rrëfime, shkrime, piktura, skulptura, por edhe për këndim të rapsodëve popullorë. Ky luftëtar fitoi popullaritet dhe simpati të madhe tek të gjitha shtresat e ndryshme të popullatës shqiptare në Kosovë, por edhe në trojet e tjera etnike; madje, mund të thuhet se, akti madhor i tij, i pushtoi zemrat e shqiptarëve, kudo që ndodheshin, i mahnitë dhe popujt e tjerë të botës. Kështu, gjatë kësaj periudhe me mijëra e mijëra njerëz brohorisnin rrugëve të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë, të trojeve të tjera etnike, si dhe të diasporës, duke demonstruar kundër dhunës institucionale serbe.

Heroizmi i pashoq i Adem Jasharit depërtoi thellë në zemrat e shqiptarëve, pa marrë parasysh moshën dhe gjininë. Edhe fëmijët nëpër sheshe e kudo, këndonin këngë për të. Poetët shkruan vjersha dhe rapsodët popullorë kënduan këngë, duke e shndërruar në përmendore lirie. Kudo e çdo ditë dëgjoheshin këngë për Adem Jasharin. Kjo përditshmëri e bënte të gjallë figurën e tij, ngjallte shpresën dhe guximin për qëndresë dhe luftë kundër armikut.

*N'ball të trimave të vatanit,
Komandant Adem Jashari
Zemërtrimi pushkën n'sy,*

*Bini trima për liri!*¹

Në vazhdim të këtij punimi do t'i marrim në shqyrtim disa këngë të krijuara në frymën popullore që trajtojnë ngjarjen e Prekazit dhe figurën e Adem Jasharit si dramë të madhe kombëtare, akt të krenarisë. Kjo dramë me fatin e protagonistëve të saj barazohet me tragjeditë më të njohura të popujve të botës, sepse dhembje, tronditje të madhe shkakton mosha e atyre që u viktimizuan, njëmbëdhjetë prej tyre ishin fëmijë, të cilët ende s'e kishin shijuar fare jetën. Ata në vend të librave dhe lodrave morën bombat dhe plumbat e ushtrisë serbe. Drenica, sipas këngës popullore, posaçërisht fshati Prekaz, si në të kaluarën ashtu dhe në të tashmen, ishte dhe mbeti vatër e qëndresës e luftës dhe sakrificës sublime për atdhe, ndaj me të drejtë rapsodi popullor këtë vatër lirie, Drenicën dhe Prekazin e kanë himnizuar:

Sa t'ketë diell, o sa t'ketë hanë,

*Jam Drenica që më kanë thanë!*²

Natyrisht, Drenica i bëhet këngëtarit mjet poetizimi. Ajo këtu kthehet në një personazh me ndjeshmëri që mishërohet me atmosferën e luftës për liri në një anë dhe në anën tjetër të barbarisë së armikut që djeg, shkatërron e shkreteton çdo gjë para vetes.

Ç'janë këto gjamë si herave tjera?

N'atë Drenicë, o na u ndal Pranvera!

Janë shembë kullat, e janë djegë livadhet,

*Ka dalë serbi e po na çelë varret!*³

Lufta e familjes Jashari, që mbron nderin e shtëpisë dhe të mbarë kombit, kundër forcave të armatosura serbe që bëjnë krime e masakra

¹ Muharrem Gashi, Këngë popullore II, Prishtinë, 2017. f.302.

² Arif Vladi, *Kanga për Drenicën*. Marrë nga një audiokasetë.

³*Po aty.*

mbi të, mund të konsiderohet e pazakonshme, sepse shteti nuk do të duhej të luftonte me tërë potencialin ushtarak me një familje, por pushtuesi serb e bën këtë, e ka bërë shumë herë dhe pikërisht në Prekaz tri herë me radhë.⁴

Kënga flet me hiperbolizime tradicionale të epikës sonë për figurën heroike të përmasave të mëdha të Adem Jasharit, i cili, sipas saj, u rri armiqve përballë dhe e bën luftën në këmbë, duke i tmerruar armiqtë:

*Sikur shkambi Ademi në kambë,
Po ua pret plumbat me dhambë!*³⁰

Ose:

*Qielli rrxohet, kulla dridhet,
Pyet Kosova:- Ku e kam Ademin?
Po e mban kullën për themeli.
Qielli rrxohet, kulla s' dridhet,
Gjylja e topit n'gjoks i shkrihet!*⁵

Sakrifica e Adem Jasharit me familje u dha zemër shqiptarëve që të mobilizohen, të marrin guxim për luftën që po e bënte Kosova për pavarësi në kohën të vështira të robërisë, ndaj radhët e luftëtarëve të lirisëgjithnjë vinin duke u rritur me luftëtarë të rinj, çliroheshin territore dhe tmerroheshin armiqtë:

*Vjen Buroja, vjen Aqareva,
Mbushën malet plot Adema.*⁶

⁴ Për tri sulmet e Serbisë në familjet shqiptare kemi këngët për personazhet kryesore: për Ahmet Delinë, Tahir Mehen dhe Adem Jasharin.

³⁰ Kënga: *Këtu shkëlqen plisi*. H. Geci. Këndon Ilir Shaqiri.

⁵ Kënga: *Këtu shkëlqen plisi*. H. Geci. Këndon Ilir Shaqiri.

⁶ *Po aty*.

Krijimi gojor poetik: *Kanga për Adem Jasharin*, këndon figurën e Adem Jasharit, martirizimin e tij dhe të familjes në luftë kundër okupatorit serb, më 1998. Ademin e përshkruan sikurse heronjtë e traditës sonë, duke e cilësuar dhe madhëruar heroizmin e tij të pashoq në përballje me armikun, që në kuptimin simbolik nuk ka mort:

*Lumja kulla, o ka ka mrena,
Oh, ka Ademin me shtatë zemra.*⁷

Teksti dhe konteksti i vargjeve të lartshënuara, dëgjuesit i japin informacion të mjaftueshëm se toposet e këtilla i hasim dendur në shumë këngë popullore historike të periudhave të mëhershme, ku rapsodët në mënyrë poetike i skalisin figurat e heronjve shqiptarë. Këta luftëtarë nuk kanë frikë nga vdekja, sepse e kanë mundur, ata janë më të fortë sesa kullat dhe armët-topat e armikut. Ata janë të palëkundur në qëndrimet dhe në përcaktimin e tyre për sakrificë sublime, për t'i përmbushur idealet e tyre të larta kombëtare.

Përpjekjet dhe lufta e pandërprerë e popullit të Kosovës gjatë periudhës së viteve 1981-1999 në fushëbetejë bëri kthesë të madhe në jetën tonë, në mendimet, veprimet dhe në vizionin për të ardhmen më të lumtur. Kjo distancë kohore është e mbushur përplot ngjarje të dhembshme e krenare për popullin shqiptar që këndohen, përjetësohen dhe interpretohen nga rapsodët e ndryshëm. Në këto këngë trajtohet në mënyrë të fuqishme vendosmëria, sakrificat e Adem Jasharit, e familjes së tij, e luftëtarëve të tjerë për çlirim dhe pavarësim të Kosovës.

Dimension i veçantë i këtyre krijimeve poetike gojore është strategjia dhe angazhimi i udhëheqësve-komandantëve të UÇK-ës, në përballje me armikun shumë më të fuqishëm, planifikimi i aksioneve

⁷Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Dosja e Nebi Balës, (Kanga për Adem Jasharin).

luftarake kundër tij si dhe mbrojtja në rast sulmi. Ata për ta ngritur moralin luftarak tek ushtarët e tyre, vetë prinin në beteja e luftëra të ndryshme, duke u dhënë shembull se si luftohet e vdiset për atdhe, i tillë ishte Adem Jashari, ndaj vargjet e këngës popullore e paraqesin në këtë mënyrë:

*Thërret Ademi, Hamëz o vlla,
Zinjau pritën mirë matanë,
Krah për krah me dajën Osman
N' ktër anët nihet jehona,
Po luftojnë këta djem sokola.*⁸

Po të vështrohen me kujdes këngët që i shqyrtuam më lart dhe ato që nuk i shqyrtuam e që janë të shumta, sidomos për komandant Adem Jasharin dhe heronjtë e tjerë të UÇK-së, mund të përfundojmë se ato paraqesin një begati letrare, si në aspektin përmbajtjesor ashtu dhe artistik, duke i pasqyruar ngjarjet dhe protagonistët e rinj që shpejt janë shndërruar jo vetëm në figura historike, por edhe artistike.

Lufta dhe sakrifica e familjes Jashari është e veçantë, dhe si e tillë vështirë se mund të haset me numër aq të madh të flijuarish, shumica nxënës, që në vend të diturisë morën plumbat e Serbisë, ndaj meriton vështrim dhe analizë të shumanshme.

Këto krijime poetike gojore që i kushtohen Adem Jasharit dhe heronjve të tjerë, po të shikohen nga pikë vështrimi i jashtëm dhe i brendshëm, del në pah e dhëna se strukturën e këtyre krijimeve e karakterizon një shtresim i ri kronologjik-historik-informativ që ka për qëllim ta paraqesë në radhë të parë lexuesit e botës argumentin historik me disa karakteristika të ndërtimit kompozicional. Ato pasqyrojnë hollësisht në mënyrë të vazhdueshme vuajtjet, qëndresën, sakrificën

⁸ Muharrem Gashi, *Këngë popullore II*, Prishtinë, 2017. f. 302.

dhe luftën e popullit shqiptar nën sundimin e huaj, duke u munduar që ta ruajnë identitetin kombëtar, në raport me dhunën që ushtronte shteti okupues serbosllav, por dhe organizimin dhe mobilizimin e rinisë tonë në luftë kundër tij.

Në fund do thënë se këngët që i kushtohen Adem Jasharin, familjes së tij, si dhe luftëtarëve të tjerë nga rapsodët e ndryshëm, siç janë: Arif Vladi, Leonora Jakupi, Ilir Shaqiri, Shkurte Fejza, Muharrem Gashi, Shaban Shishmani etj., paraqesin një dëshmi dhe vlerë të veçantë në folkloristikën tonë. Ato e madhërojnë figurën e Adem Jasharit duke e ngritur në përmendore lirie, që rrezaton atdhe dashuri të përmasave të mëdha në kohë e hapësirë gjithëshqiptare dhe më gjerë për brezat në vijim. Po ashtu, këto këngë e pasqyrojnë në mënyrë të hollësishme realitetin jetësor e historik të popullit tonë në një periudhë të caktuar. Lufta dhe sakrifica e tyre solli ndryshme të ndjeshme, jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe në ndryshimet gjeopolitike brenda zonës së Ballkanit dhe përgjithësisht të Evropës Juglindore.

Këngët që i kushtohen veprës së Adem Jasharit janë të shumta, por relativisht të reja. Ato në strukturën e tyre ngërthejnë vlera të shumta përmbajtjesore dhe artistike, duke e paraqitur në mënyrë të hollësishme realitetin jetësor e historik të qëndresës dhe luftës sonë në një periudhë të caktuar, që me të drejtë karakterizohet si njëra ndër më të vështirat në historinë tonë. Këngët për Adem Jasharin dhe UÇK-në edhe pse shumicës iu dihen autorët, janë krijuar brenda një periudhe të shkurtër, sepse kanë qenë të nevojshme që të krijohen e këndohen, duke pasur parasysh kohën dhe rrethanat e ndërlikuara shoqërore e politike nëpër të cilën ka kaluar populli dhe lufta e jonë. Këngët e kënduara e kanë luajtur rolin e tyre të jashtëzakonshëm, duke nxitur, frymëzuar e mobilizuar popullin për qëndresë, luftë e sakrificë. Ato tani, me kalimin

e kohës, duhet ta kalojnë edhe censurën kolektive, me ç'rast do të plotësohen, avancohen dhe funksionalizohen në shkallë edhe më të lartë, si tekst poetik dhe melodi, siç kanë kaluar më parë edhe krijimet e tilla popullore që njihen në folkloristikën tonë.